



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH .nr.388/20**  
**390/20**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “DINO” sh.p.k-Lipjan dhe ankesës së OE “REXHA SHPK”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “FIDOLA dhe Nartel Exin”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me nr. të prok: 616-19-9686-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 27.07.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “DINO” sh.p.k-Lipjan dhe OE “REXHA SHPK”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me nr. të prok: 616-19-9686-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me nr. të prok: 616-19-9686-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “DINO” sh.p.k-Lipjan dhe OE “REXHA SHPK”-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “DINO” sh.p.k-Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 15.06.2020 me nr.388/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me nr. të prok: 616-19-9686-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 51 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE “REXHA SHPK”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 15.06.2020 me nr.390/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me nr. të prok: 616-19-9686-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 10, 27, 52, 59, 60, 61, 65 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.06.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 02.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**OE “Rexha” Përgjigje në Pretendimi nr.1**, Sa i përket pretendimit të OE ankues “Rexha” se autoriteti kontraktues e ka eliminuar patë drejtë duke u arsyetuar se nuk kemi dorëzuar referenca të ndërtimit të lartë, kjo nuk qëndron pasi që AK në sqarimin e datës 31.01.2020 ka cekuar “Nuk pranohen eksperiencia e punës së



renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10 te ligjit për ndërtim NR.04 L-110”. Ne kemi prezantuar të gjitha kontratat/referencat që tejkalojnë këtë vlerë dhe për këtë është dëshmitar edhe vetë AK pasi që kemi kontrata me ata. Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Për çështjen që është ngritur pretendimi ankimor, kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë: “Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ndërtimeve te reja, (ndërtim i larte) ne vlere minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri ) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë(ne rast konzorciumi udhëheqësi i konzorciumit duhet te plotësoj te paktën60% te kërkesës)” Ndërsa dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit për këtë pikë ka qenë: “Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 4 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve” Lidhur me këtë pikë ka pasur edhe pyetje sqaruese që ju ka dërguar AK-së nga një OE gjatë kohës së marrjes së dosjes së tenderit dhe përgjigjja për këtë është dhënë nga AK me datë 31.01.2020. Pyetja sqaruese nga një OE ka qenë: “Pasi qe edhe renovimet e objekteve hyjnë ne kategorinë e ndërtimit te larte, atëherë a mund te na tregoni se a njihen si referenca eksperiencia e punës ne renovimin e objekteve te larte?” Lidhur me këtë pyetje është përgjigjur AK me datën 31.01.2020 me këtë sqarim: “Nuk pranohen eksperiencia e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10 te ligjit për nderim NR.04 L-110” Megjenëse OE ankues ka tenderuar si konzorcium dhe lideri i konzorciumit është OE “Rexha”, atëherë sipas kërkesës së DT, i bie që lideri duhet ti ketë projekte të kryera në vlerë prej 4.500.000,00 € dhe referencat, apo raportet e pranimit për këto projekte. Nga këto që u potencuan më lartë shihet se AK ka potencuar disa herë që projektet e kryera duhet të janë ndërtimi i lartë dhe përveç kësaj thekson që nuk pranohen as punët që kanë të bëjnë me renovime. OE ankues ka ofruar listën e projekteve të cilat kryesisht janë punë të kryera në ndërtimin e ulët si ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve, ndërtimi i bulevardeve, rregullimi i terreneve sportive, sanimi i dyshemesë urbane në shesh, ndërtimi i parqeve dhe punime të renovimeve të objekteve etj të ngjashme. Për mendimin e ekspertit këto projekte nuk janë ndërtimit të lartë. Kur listës së projekteve të dorëzuar me ofertë nga OE ankues “Rexha” i largohen projektet e natyrës së përmendur më lartë, mbesin vetëm pak pakë projekte të ndërtimit të lartë të cilat nuk e përmbushin as për së afërmi vlerën e kërkuar në DT për liderin, prej 4.5 milion euro. Prandaj mbi këtë bazë eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor tëpa bazuar.

**Përgjigje në Pretendimi nr.2,** Në pretendimin tjetër të OE ankues “Rexha” se AK nuk ka marrë për bazë qarkullimin e dërguar nga ATK për vitin 2016, 2017 dhe 2018 si dhe qarkullimin nga banka për vitin 2019 dhe nuk ka kukuar sqarime shtesë për këtë çështje por e ka vlerësuar si pikë e pa plotësuar. Po ashtu edhe për pozicionin nr.9 në paramasë te objekti 3 se është i përsëritur dy herë, AK nuk e vlerëson në pajtim me nenin 59 pika 3 si tolerancë deri 2% të vlerës totale të ofertës. Eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Sa i përket qarkullimi të OE ankues për tri vitet e fundit, në një formë e pranohet edhe vetë AK ne përgjigjeje te kërkesë për rishqyrtim



se arsyeja pse nuk është kërkuar sqarime shtesë, ka qenë për shkak se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën për projektet e kryera dhe referencat e dorëzuar dhe ne këtë rast një sqarim i tillë pavarësisht rezultatit nuk do të kishte efekt. Ndërsa përsëritja e pozicionit në fjalë ekziston në ofertën e OE ankues, mirëpo i njëjti nuk është arsye për eliminim sepse mundet të trajtohet si devijim i vogël sipas nenit 59 të LPP-së dhe nuk e kalon vlerën prej 2% të totalit të ofertës. Në përgjithësi ky pretendim ankimor është i bazuar.

**Përgjigje në Pretendimi nr.3,** Pretendimin tjetër i OE ankues “Rexha” se autoriteti kontraktuesi ka pranuar OE të rekomanduar për kontratë certifikatat ISO të pa noterizuara, kur kërkesa në DT ka qenë se duhet të janë të noterizuara, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE i rekomanduar për kontratë, certifikatat ISO i ka ofruar në origjinal. Dokumenti në origjinal është më i besueshëm edhe juridikisht se sa kopja e atij dokumenti e noterizuar. Qëllimi i kërkesë në DT është që OE të posedojë certifikatat dhe kërkesa për noterizim është nëse të njëjtat ofrohen si kopje. Kjo këtë kuptim ka. Përndryshe ofrimi i dokumentit në origjinal e arrin efektin për të cilën është kërkuar. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të pa bazuar.

**Përgjigje në Pretendimi nr.4,** Lidhur me pretendimin e OE ankues “Rexha” se autoriteti kontraktues e ka pranuar projektin e OE të rekomanduar për kontratë “Ndërtimi i spitalit pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike, QKUK” edhe pse i njëjti OE nuk posedon referencë nga vet AK këtë rast QKUK, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private. Shprehja apo përkufizimi “Autoritet kontraktues” nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private. Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit. Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

**OE “Dino” Përgjigje në Pretendimi nr.1,** Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “Dino” se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit të aftësitë teknike dhe/ose profesionale që ka të bëjë me inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës i cili nuk e ka 5 vite përvojë pune sepse i njëjti ka diplomuar me datën 08.10.2015, ndërsa njoftimi për kontratë është bërë me datën 30.12.2019, pra nga kjo shihet qartë se inxhinieri në fjalë nuk i ka 5 vite përvojë pune. Ky fakt është pranuar edhe nga AK por është konsideruar si devijim i vogël. Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Nga kërkesa e dosjes së tenderit për Inxhinier të diplomuar të elektroteknikës kërkohet 5 vite përvojë pune dhe udhëheqës i punishtes së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme. Dokumentet e përvojës dhe diplomat e Inxhinierit në fjalë që i ka dorëzuar me ofertë OE i rekomanduar për kontratë figuron se është i diplomuar “Master me 23 nëntor të vitit 2015 që rrjedhimisht nga kjo periudhë nuk i ka 5 vitet të plota si inxhinier i diplomuar mastër. Kjo pjesë e kësaj pike të DT nuk është plotësuar tërësisht edhe pse i njëjti



inxhinier sipas CV sëtijë ka qenë i diplomuar si Bachelor në vitin 2012 dhe nga ajo kohë ka punuar në projekte të ndryshme si inxhiniermbikëqyrës. Nga CV-ja einxhinierit në fjalë shihet se i njëjta ka udhëhequr dy projekte të natyrës së ngjashme. Prandaj ky pretendim ankimor vlerësohet si pjesërisht i bazuar.

**Përgjigje në Pretendimi nr.2,** Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues “Dino” se autoriteti kontraktuese ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kresat e dosjes së tenderit lidhur me pajisjet sepse tek dëshmitë për kamionë shihet qartë se Kamioni me targa 01-745-JN dhe Kamioni me targa 01-957-HK ju ka skaduar afati i regjistrimit para njoftimit për kontrate, andaj AK-ja është dashur ti merr parasysh këto pretendime tona. Kamioni me targa 01-745-JN i ka skaduar regjistrimi me dt.24.07.2018, pra mbi një vit e gjysmë para datës së dorëzimit të ofertave. Kamionit me targa 01-957-HK i ka skaduar afati i regjistrimit me dt.28.06.2019. Për këtë pretendim ekspertit shqyrtues ka këtë mendim. Kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

**Përgjigje në Pretendimi nr.3,** Sa i përket pretendimit të fundit ankimor të OE ankues “Dino” se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar certifikatën OHSAS 18001 2007 dhe certifikatën ISO 27001 2013, ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

Kërkesa e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë fillimisht ka qenë që të ofrohen nga tenderuesit 6 certifikata. Mirëpo kjo është korrigjuar nga AK sipas njoftimit për NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE OsePERMIRESIM I GABIMIT të datës 21.01.2020. Me këtë njoftim të AK, janë larguar nga kërkesa dy certifikata. Shih tabelën në vijim nga njoftimi për korrigjim i AK-së.

| Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet | Në vend të                                           | Është        |
|---------------------------------------------|------------------------------------------------------|--------------|
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale    | 6. O.E. duhet të posedoj certifikatën ISO 27001 2013 | Nuk kërkohet |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale    | 8. O.E. duhet të posedoj certifikatën PAS 99 2012    | Nuk kërkohet |

Pra OE i rekomanduar nuk e ka ofruar certifikatën ISO 27001 2013 sepse kjo është larguar si kërkesë nga AK gjatë sqarimeve shtesë dhe si e tillë nuk ka qenë e obligueshme. Ndërsa për certifikatën tjetër OHSAS 18001 2007, në vend të sajë, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar si zëvendësim certifikatën ISO 45001:2018 me të avancuar. Pra kjo Çertifikatë e e vitit 2018 e zëvendëson atë të vitit 2007. “ISO 45001:2018 replacing OHSAS 18001:2007”. Si e tillë kjo është nërregullë dhe e plotëson kërkesën e AK-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve në përgjithësi ka respektuar dispozitat e LPP-së. Është eliminuar si i pa përgjegjshëm OE ankues “Rexha” për shkak të mos plotësimit të kërkesës së DT për projektet të kryera në ndërtimin e lartë nga lideri i konzorciumit në vlerë prej 4.5 milion euro. Ndërsa është kualifikuar si i pa suksesshëm OE ankues “Dino”. OE ekonomik i rekomanduar për kontratë ka pasur disa devijime të kërkesave të dosjes së tenderit që lidhet me përvojën e inxhinierit të elektroteknikës i cili për disa muaj nuk e ka përmbushur përvojën 5 vjeçare. Kjo është vlerësuar nga AK si devijim i vogël bazuar në nenin 59 të LPP-së. Tani sipas LPP-së dhe RRUOPP të qenit “në pajtueshmëri” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosjetë tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime. Pra nga ky përkufizim ligjor lejohen devijime të cilat nuk janë substanciale si në rastin konkret. Ky devijim për mendimin e ekspertit shqyrtues është i pa përfillshim në këtë aktivitet të prokurimit. Kur kemi për bazë edhe ofertën financiare të OE “Dino” e cila është mbi 1.000,000,00 € me e lartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë, atëherë vlerësojmë se me këtë rast respektohet edhe nenin 1 dhe 6 i LPP-së. Nuk ka shkelje nga AK që e dëmtojnë procesin e prokurimit.

Mbi bazën e asaj që u tha më lartë, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues “Rexha” dhe “Dino” të aprovohen pjesërisht, bazuar në sqarimet e dhëna më lartë. Por kjo nuk do të ndikoj në ndryshimin e vendimit të AK-së.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të Vazhdoj me dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Tregu i ri i qytetit” me nr. prok. 616-19-9686-5-1-1 në bazë të dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.07.2020, me anë të shkresës zyrtare janë njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo te njëjtë nuk kane kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik “DINO” sh.p.k-Lipjan, me datë: 02.07.2020, me anë të shkresës zyrtare janë njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo te njëjtë nuk kane kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik “REXHA SHPK”-Prishtinë, me datë: 06.07.20250, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit



për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaronse ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

#### **Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE të parë ankues "Rexha" shpk**

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Rexha" se autoriteti kontraktues e ka eliminuar pa të drejtë duke u arsyetuar se nuk kemi dorëzuar referenca të ndërtimit të lartë, kjo nuk qëndron pasi që AK në sqarimin e datës 31.01.2020 ka cekur "Nuk pranohen eksperiencia e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit të nenit 3 paragrafi 1.10 të ligjit për ndërtim NR.04 L-110)". Ne kemi prezantuar të gjitha kontratat/referencat që tejkalojnë këtë vlerë dhe për këtë është dëshmitar edhe vetë AK pasi që kemi kontrata me ata.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit sqaron se kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë: **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ndërtimeve të reja, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë (në rast konzorciumi udhëheqesi i konzorciumit duhet të plotësojë të paktën 60% të kërkesës).** Ndërsa dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit për këtë pikë ka qenë: **Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.** Lidhur me këtë pikë ka pasur edhe pyetje sqaruese që ju ka dërguar AK-së nga një OE gjatë kohës së marrjes së dosjes së tenderit dhe përgjigjja për këtë është dhënë nga AK me datë 31.01.2020. Pyetja sqaruese nga një OE ka qenë: "Pasi që edhe renovimet e objekteve hyjnë në kategorinë e ndërtimit të lartë, atëherë a mund të na tregoni se a njihen si referenca eksperiencia e punës në renovimin e objekteve të lartë?" Lidhur me këtë pyetje është përgjigjur AK me datën 31.01.2020 me këtë sqarim: "Nuk pranohen eksperiencia e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve të larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit të nenit 3 paragrafi 1.10 të ligjit për ndërtim NR.04 L-110)". Meqenëse OE ankues ka tenderuar si konzorcium dhe lideri i konzorciumit është OE "Rexha", atëherë sipas kërkesës së DT, i bie që lideri duhet të ketë projekte të kryera në vlerë prej 4.500.000,00 € dhe referencat, apo raportet e pranimit për këto projekte. AK ti sqaroi kontratat e OE ankues konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së nga lista e ofruar se a e plotësojnë këtë kërkesë të AK-së.



Lidhur me pretendimin e OE ankues “Rexha” se AK nuk ka marrë për bazë qarkullimin e dërguar nga ATK për vitin 2016, 2017 dhe 2018 si dhe qarkullimin nga banka për vitin 2019 dhe nuk ka kërkuar sqarime shtesë për këtë çështje por e ka vlerësuar si pikë e pa plotësuar. Po ashtu edhe për pozicionin nr.9 në paramasë te objekti 3 se është i përsëritur dy herë, AK nuk e vlerëson në pajtim me nenin 59 pika 3 si tolerancë deri 2% të vlerës totale të ofertës, Paneli shqyrtues vlerëson se sa i përket qarkullimi të OE ankues për tri vitet e fundit, në një formë edhe vetë AK e ka pranuar ne përgjigjeje te kërkesë për rishqyrtim se arsyeja pse nuk është kërkuar sqarime shtesë, ka qenë për shkak se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën për projektet e kryera dhe referencat e dorëzuar dhe ne këtë rast një sqarim i tillë pavarësisht rezultatit nuk do të kishte efekt. Ndërsa përsëritja e pozicionit në fjalë ekziston në ofertën e OE ankues, mirëpo i njëjti nuk është arsye për eliminim sepse mundet të trajtohet si devijim i vogël sipas nenit 59 të LPP-së dhe nuk e kalon vlerën prej 2% te totalit te ofertës, andaj ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Pretendimin tjetër i OE ankues “Rexha” se autoriteti kontraktuesi ka pranuar OE të rekomanduar për kontratë certifikatat ISO të pa noterizuara, kur kërkesa në DT ka qenë se duhet të janë të noterizuara, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë, certifikatat ISO i ka ofruar në origjinal. Duke pasur parasysh faktin se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë "...certifikat ISO të noterizuara", dhe duke pasur parasysh faktin se dokumentet janë dorëzuar në mënyrë elektronike përmes sistemit të e-prokurimit dhe jo në kopje fizike, paneli shqyrtues vlerëson se AK ka qenë dashur që këtë çështje ta sqarojë me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë më saktësisht të kërkoj nga OE që të njëjtat ti sjellë konform kërkesës, andaj paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Rexha” se autoriteti kontraktues e ka pranuar projektin e OE të rekomanduar për kontratë “Ndërtimi i spitalit pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike, QKUK” edhe pse i njëjti OE nuk posedon referencë nga vet AK këtë rast QKUK, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private. Shprehja apo përkufizimi “Autoritet kontraktues” nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private. Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit. Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.



### **Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE të dytë ankues “Dino”**

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “Dino” se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit të aftësitë teknike dhe/ose profesionale që ka të bëjë me inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës i cili nuk e ka 5 vite përvojë pune sepse i njëjti ka diplomuar me datën 08.10.2015, ndërsa njoftimi për kontratë është bërë me datën 30.12.2019, pra nga kjo shihet qartë se inxhinieri në fjalë nuk i ka 5 vite përvojë pune, paneli shqyrtues sqaron se ky fakt është pranuar edhe nga AK por është konsideruar si devijim i vogël. Nga kërkesa e dosjes së tenderit për Inxhinierët e diplomuar të elektroteknikës kërkohet 5 vite përvojë pune dhe udhëheqës i punishtes së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme. AK të sqaroj përvojën e punës konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, se a e plotëson ky inxhinier këtë kërkesë të AK-së, andaj ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Dino” se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me pajisjet sepse tek dëshmitë për kamionë shihet qartë se Kamioni me targa 01-745-JN dhe Kamioni me targa 01-957-HK ju ka skaduar afati i regjistrimit para njoftimit për kontratë, andaj AK-ja është dashur ti merr parasysh këto pretendime tona. Kamioni me targa 01-745-JN i ka skaduar regjistrimi me dt.24.07.2018, pra mbi një vit e gjysmë para datës së dorëzimit të ofertave. Kamionit me targa 01-957-HK i ka skaduar afati i regjistrimit me dt.28.06.2019. Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë, i duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “Dino” se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar certifikatën OHSAS 18001 2007 dhe certifikatën ISO 27001 2013, paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë fillimisht ka qenë që të ofrohen nga tenderuesit 6 certifikata. Mirëpo kjo është korrigjuar nga AK sipas njoftimit për NJOFTIM PER INFORMATA SHITESHE ose PERMIRESIM I GABIMIT të datës 21.01.2020. Me këtë njoftim të AK, janë larguar nga kërkesa dy certifikata, a) 6. OE duhet të posedoj certifikatën ISO 27001 2013, b)8. OE duhet të posedoj certifikatën PAS 99 2012, pra OE i rekomanduar nuk e ka ofruar certifikatën ISO 27001 2013 sepse kjo është larguar si kërkesë nga AK gjatë sqarimeve shtesë dhe si e tillë nuk ka qenë e obligueshme. Ndërsa për

certifikatën tjetër OHSAS 18001 2007, në vend të saj, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar si zëvendësim certifikatën ISO 45001:2018 me te avancuar. Pra kjo Çertifikatë e e vitit 2018 e zëvendëson atë të vitit 2007. “SO 45001:2018 replacing OHSAS 18001:2007”. Si e tillë kjo është në rregull dhe e plotëson kërkesën e AK-së, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Blerim DINA

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE -“DINO” sh.p.k-Lipjan dhe OE “REXHA SHPK”-Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.